



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:061160

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06316234

Në ankesën e

AC-I-24-0386-A0001

Paditësi

A Z me përfaqësues B B, H.

Kundër:

E paditura/Ankuesja

N.SH "Auto Prishtina" (në likuidim), Prishtinë, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-24-0024, të datës 26 prill 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-24-0024, i datës 26 prill 2024.**
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 29 prill 2015, paditësi kishte paraqitur një padi për pagesën e pagave të mbetura të papaguara nga N.SH. "Auto Prishtina" në Prishtinë, në vlerë prej 15,340.00 euro. Në padi theksohet se paditësi nuk ka pushuar së kërkuari pagesën e pagave mujore sipas kontratës së punës deri në njoftimin se për N.SH ka filluar likuidimi kur edhe kanë marrë veprime të ndryshme ligjore për realizimin e së drejtës së tyre për pagesën e pagave dhe kontributeve për fondin pensional për periudhën e cituar dhe nga menaxhmenti i N.SH-së iu është premtuar se pagat do të paguhen falë bashkëpunimit me AKP-në. Ushtrimi i padisë është i justifikueshëm pasi që AL e kishte refuzuar kërkesën e paditësit të paraqitur brenda afatit dhe me prova të mjaftueshme për vendosje. Aktvendimi i Autoritetit të Likuidimit është tërësisht i pabazuar në fakte dhe prova si dhe në dispozitat ligjore në fuqi në lidhje me të drejtën e të punësuarit në N.SH. AKP, gjegjësisht e paditura ka qenë tërësisht e njoftuar me zhvillimet në këtë N.SH dhe ajo ka pasur nën menaxhim me obligim ligjor gjë që nuk ka arritur që detyrimin e saj ta realizoj në harmoni me ligjet dhe rregulloret e UNMIK-ut dhe Organeve Administrative Shtetërore të Republikës së Kosovës. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, paditësi i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet padia e paditësit, ndërsa të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj borxhin kryesor për pagat e mbetura të papaguara për periudhën tetor 2003-qershor 2014 në shumën prej 15,340.00 euro si dhe kamatën ligjore vjetore në vlerë prej 3.5% për çdo vit. Padisë i kishte bashkëngjitur: autorizimin për përfaqësim, numrin e regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist .. të SH.A "Auto Prishtina", konfirmimin për pranimin e fletëparaqitjes për regjistrimin e përkohshëm të subjektit afarist SH.A "Auto Prishtina", në njoftim Autoritetit të Likuidimit të N.SH "Auto Prishtina" nga paditësi i datës 23 prill 2015, një shkresë e AKP-së e datës 18 nëntor 2004, shkresë e AKP-së e datës 19 gusht 2004, lista e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e datës 12 qershor 2014, një kontratë pune e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës e datës 13 tetor 2003 si dhe një deklaratë e paditësit A Z se N.SH në fjalë ka obligime ndaj të njëjtit për pagat e papaguara.

Me datë 1 prill 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e tij në të cilën theksohet se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin

74.2 të LDHP-së i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, theksohet se kërkesa e parashtruesit është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Qëndrimi i palës kundërshtarë është se afati i parashkrimit nuk lejon që Autoriteti i Likuidimit dhe DHPGJS të analizojnë dhe shqyrtojnë themelin e rastit. Vetë kuptimi i parashkrimit është vjetërsimi i një të drejtë të pretenduar për shkak të kalimit të afateve të përcaktuara me ligj që vështirësojnë vërtetimin e rrethanave të çështjes pikërisht për shkak të kohës që ka kaluar. Pala kundërshtarë rikujton se natyra e lëndës është përsëritëse-pra ka një jurisprudencë të konfirmuar disa herë të DHPGJS e cila trajton këto lloj pretendimesh. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së.

Me datë 22 qershor 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0694 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se pas shqyrtimit të provave që i kanë ofruar palët ndërgjyqëse, gjykata ka konstatuar se pala paditëse ka qenë në marrëdhënie pune në N.SH "Auto Prishtina", gjë që vërtetohet nga kontrata e punës e cila gjendet në shkresa të lëndës. N.SH "Auto Prishtina" me datë 21 korrik 2014, ka hyrë në procedurën e likuidimit, ku AL duke u bazuar në nenin 8 të Shtojcës së Ligjit për APK-në në të cilin parashihet se *"mesnatën e datës së vendimit për likuidim, ndërpriten të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë"*, i ka ndërprerë të gjitha kontratat ekzistuese. Pala paditëse me datë 11 shtator 2014, pranë AL-së kishte paraqitur kërkesën për kompensim të pagave të papaguara, e cila kërkesë ishte shqyrtuar me vendimin PRN126-0190 të datës 31 mars 2015 dhe ishte refuzuar si e pabazuar. Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 376.1 të LMD-së dhe në pajtim me nenin 54 lidhur me nenin 74 të Ligjit për DHPGJS-në kishte vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me datë 14 korrik 2022, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-0694 të datës 22 qershor 2022, për shkak të konstatimit jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të

prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje tek DHPGJS. Në ankesë theksohet se arsyetimi i aktgjykimit është kontradiktor në raport me provat në shkresa të lëndës, ngase gjykata vlerëson se borxhi i përket periudhës nga viti 2003 deri në vitin 2014 dhe në shkresa të lëndës ekzistojnë prova materiale që dëshmojnë raportin juridik të punës me të drejta dhe detyrime mes paditësit dhe të paditurës deri në fillimin e likuidimit të saj në vitin 2014, përderisa padia është paraqitur në vitin 2015. Atëherë si është e mundur që të jetë parashkruar kërkesa kur e njëjta është bërë e arritshme në vitin 2014 derisa padia është paraqitur në vitin 2015, aq më tepër kur vet e paditura ka hartuar listën me nr. 4 të datës 12 qershor 2014 me emrat e punonjësve që kanë mbetur pa iu paguar pagat nga e paditura. Andaj duke pasur parasysh të lartcekurat, paditësi konsideron se nuk mund të vie në shprehje parashkrimi i kërkesës. Tutje, paditësi thekson se aktgjykimi i ankimuar përmban edhe shkelje esenciale procedurale për shkak të mos mbajtjes së seancës përgatitore dhe pa i marrë për bazë faktet dhe privat e paditësit, pa dhënë asnjë vlerësim për to, gjë që i ka pamundësuar paditësit deklarin rreth objektit të çështjes, duke shkelur kështu parimin e kontradiktoritetit si parim fundamentale i LPK-së. Prandaj duke pasur parasysh të lartcekurat, paditësi i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë.

Me datë 10 tetor 2022, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit, në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura, andaj i propozon Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Me datë 22 shkurt 2024, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-22-0398-A0001, ankesën e paditësit e aprovon si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën e kthen në rigjykim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se ndërmarrja në fjalë kishte hyrë në procedurë të likuidimit me datë 21 korrik 2014. Paditësi në shkallë të parë kishte dorëzuar si provë një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e datës 12 qershor 2014 e nxjerrë nga vet N.SH-ja. Në këtë listë shihet që vet N.SH e pohon shumën e borxhit që e ka ndaj paditësit. Kolegji i Apelit kishte vërejtur se shkalla e parë e DHPGJS-së me rastin e vendosjes së kësaj çështje e përmend vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN126-0190 të datës 31 mars 2015, me të cilin ishte shqyrtuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara.

Vendimi në fjalë nuk gjendet në shkresat e lëndës. As ankuesi në asnjë parashtresë të veten nuk ishte thirrur në vendimin në fjalë. Andaj Kolegji i Apelit konsideron se për rastin në fjalë, Shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vendosur në merita pa i shqyrtuar kushtet e pranueshmërisë së ankesës të parapara në nenin 73 të Ligjit për DHPGJS-në. Gjithashtu, Kolegji i Apelit kishte vlerësuar se ankesa e ankuesit nuk mund të konsiderohet tërësisht e parashkruar për faktin se i njëjti kishte parashtruar një provë, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë rrogat sipas kontratës së punës e datës 12 qershor 2014. Kjo do me thënë se 36 muaj paraprak deri në momentin kur NSH-ja kishte hyrë në procedurë të likuidimit me datë 21 korrik 2014 nuk ishin pashkruar. Në këtë listë vërehet se organet kompetente të NSH-së kishin pranuar faktin se ndaj punëtorëve në fjalë në mesin e të cilëve ishte edhe paditësi nuk ishin paguar në tërësi pagat për muajt e kërkuar. Kjo parashtresë kishte ndërprerë parashkrimin.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim ajo regjistrohet me numrin, C-IV-24-0024.

Me datë 05 mars 2024, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një Urdhër për paditësin, me të cilin kërkohet që ai të dorëzon Njoftimin për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe dëshmi dhe prova shtesë nëse ka në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me llogaritjen e kohës dhe shumës së kërkuar.

Me datë 14 mars 2024, paditësi e dorëzoi një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Me këtë parashtresë ai ka dorëzuar Autorizimin e Avokatit, Letër konfirmim për përvojën e punës të lëshuar nga AKP-ja, Kopjen e Kontratës së punës të vitit 2003, Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, një Vendim tjetër të Autoritetit të likuidimit, që nuk është objekt i ankesës, Listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat sipas Kontratës së punës nr.prot 4 datë 12.06.2014, Aktvendim të pushimit vjetor të vitit 2004, Deklaratë e ish Drejtorit të NSH-së, I S, një Deklaratë tjetër e paditësit dhe Vendimin për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së.

Me datë 08 prill 2024, AKP-ja e dorëzon edhe një herë mbrojtjen në ankesën e paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i përsëritë pretendimet e veta që i kishte paraqitur më herët në mbrojtjen në ankesë të dorëzuar me 01 prill 2022.

Me datë 23 prill 2024, paditësi e dorëzon një parashtresë dhe përgjigjet në këtë parashtresën e fundit të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i ka përsëritur pretendimet e veta të cekura në parashtresat e deritanishme. Bashkë me këtë parashtresë ai dorëzon disa kopje të Aktgjykimeve aprovuese të shkallës së I-rë të DHPGJS-së të punëtorëve tjerë të kësaj NSH-je.

Me datë 26 prill 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ankesën e paditësit e aprovon pjesërisht si të bazuar e ndryshon Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e obligon AKP-në që paditësit në emër të pagave të papaguara për 36 muaj nga qershor 2011 e deri në qershor 2014 ti paguaj shumën prej 4,248.00 euro, interesin ligjor prej 10% të shumës themelore, në shumë prej 424.80 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Me pikën e 5 të dispozitivit, shkalla e I-rë e refuzon si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesës në shumë prej 11,902.00, si dhe shpenzimet e përfaqësimit prej 208 euro. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte të themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i rregullt me kontratë të punës në NSH "Autor Prishtina- Prishtinë (në likuidim)", me pagë mujor prej 203.20€. Nuk ka qenë kontestuese as fakti se ankuesi për punë e kryer kishte realizuar për çdo muaj nga 85 €, si akontacion. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: vendimin e kundërshtuar, listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marr rrogat sipas kontratës së punës, kontrata e punës me NSH në fjalë, si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se ndër të tjera kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara është parashkrua. Nga, lista e punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë realizuar të ardhurat personale sipas kontratës së punës, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH "Auto Prishtina" në periudhën kohore prej muajit tetor 2003 deri në qershor 2014, kohë edhe kur shumica e aseteve të NSH-së janë shitur apo NSH është privatizuar dhe si pasojë marrëdhënia e punës së ankuesit i ka pushuar. Nga Lista e punëtorëve aktivë të cilët nuk i kanë realizuar të ardhurat personale , sipas kontratës së punës nr. 4, datë 12 qershor 2014 lëshuar nga NSH-ja, për periudhën kohore tetor 2003 – qershor 2014, (e cila nuk kontestohet nga e paditura sa i përket lartësisë së kërkesës) vërtetohet fakti se ankuesi kishte punuar në NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh ankuesit disa paga për periudhën tetor 2003 – qershor 2014 në shumë prej 15,340.00 €. Nisur nga kjo gjendje, shkalla e

I-rë i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat e cekura më lartë për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borxh pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesi, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankuesit, gjykata e aprovon pjesërisht kërkesën e tij. Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 4,248.00 €, shkalla e I-rë i njeh ankuesit 36 paga të papaguara nga muajin qershor 2011 e deri në qershor të vitit 2014, duke u bazuar në Neni 353 i LMD/së, Nr.04/L 77, pasi që konsideron se kjo pjesë e kërkesë nuk është e parashkruar, dhe duhet kompensuar. Ndërsa pjesa tjetër e kërkesë së paditësit për pagat e papaguara për muaji tetor 2003, deri në qershor 2011, shumën prej 11.902.00 €, refuzohen për shkak të parashkrimit. Shkalla e I-rë ka vlerësuar dhe analizuar edhe pretendimin e të autorizuarit të ankuesit se kemi ndërprerjeje të parashikimit, mirëpo një pretendimi i tillë është i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova dhe ligj, pasi që me asnjë provë të vetme nuk u provuar se ankuesi e kishte kërkuar pjesën tjetër të pagës se pa paguar, në rastin konkret pjesa tjetër e pagave të pa paguar duhet të llogarite si mos përmbushje e detyrimit të paditurës në raport me paditësin , dhe kjo pjesë llogarit si borxhi i pa paguar, dhe nuk hynë në institutin e ndërprerjes së parashikimit, dihet kur kemi ndërprerje të parashikimit, siç përcaktohet me dispozita ligjor të nenin 372, të LMD/së, së, për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin, për çka edhe kjo pjesë e refuzua. Shkalla e I-rë ka vlerësuar edhe pretendimin të paditurës se kërkesa e ankuesit është në tërësi e parashkruar, është i pa bazuar për pjesën e aprovuar. Shkalla e I-rë vlerëson se për periudhën qershor 2011 e tutje, parashkrimi është ndërprerë me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit, përkatësisht privatizimit të N.Sh-së. Kësisoj pretendimi i të paditurës, se kërkesa ankuesit është parashkruar për tërë detyrimin nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore, të lartcekura (neni 353 të LMD). Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 406.80 €, në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Me datë 14 maj 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-24-0024 të datës 26 prill 2024, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të vërtetohet vendimet e Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. AKP-ja ka pohuar se paditësi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të LDHP-së i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, theksohet se kërkesa e parashtruesit është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Qëndrimi i palës kundërshtarë është se afati i parashkrimit nuk lejon që Autoriteti i Likuidimit dhe DHPGJS të analizojnë dhe shqyrtojnë themelin e rastit. Tutje AKP-ja pretendon se kërkesa për paga është dashtë të paraqitet menjëherë brenda 3 vite deri në gjykatën kompetente, ndërsa kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me 11 shtator 2014, që nënkupton se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 03 gusht 2024, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këta parashtresë paditësi pohon se ai e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ndërsa i kundërshton të gjitha pretendimet ankimore të ankueses si të pabazuara në ligj. Tutje paditësi pohon se pretendimi i AKP-së se paditësi nuk ishte punëtor aktiv i NSH-së, në momentin kur filloji likuidimi i NSH-së, nuk qëndron pasi që provat materiale të cilat ekzistojnë në lëndë vërtetojnë se ai ishte punëtor i NSH-së deri me 21 korrik 2014, kur filloji procedura e likuidimit të NSH-së. Paditësi pohon se pretendimet e AKP-së janë kontraverze, nuk përkojnë me gjendjen reale, dhe AKP-ja ka tendencë të shtrembëroj provat dhe gjendjen faktike me qëllim të zvarritjes së procedurës. Paditësi i ka përsëritur edhe pretendimet tjera që ai i ka cekur në parashtresat e tij në shkallën e I-rë. Andaj nga këto arsye paditësi kërkon

që të refuzohet ankesa si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHPGJSK), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se me Aktvendimin e tij të datës 22 shkurt 2024, AC-I-22-0398, me të cilën lënda ishte kthyer në rigjykim, pos tjerash kishte konstatuar se kërkesa e paditëses për pagat e kërkuara prej NSH-së në 36 muajt paraprak para se NSH-ja të hynë në likuidim me datë 21 korrik 2014 nuk janë parashkruar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së pas kthimit të lëndës në rigjykim në bazë të shkresave të dosjes vërehet se me 05 mars 2024, e lëshon një Urdhër për paditësin, me të cilin kërkohet që ai të dorëzon Njoftimin për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, si dhe dëshmi dhe prova shtesë nëse ka në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me llogaritjen e kohës dhe shumës së kërkuar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësi si përgjigje ndaj Urdhrit me datë 14 mars 2024, e dorëzoi një parashtrësë në DHPGJS, me të cilën ai ka dorëzuar Autorizimin e Avokatit, Letër konfirmim për përvojën e punës të lëshuar nga AKP-ja, Kopjen e Kontratës së punës të vitit 2003, Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, një Vendim tjetër të Autoritetit të likuidimit, që nuk është objekt i ankesës, Listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat sipas Kontratës së punës nr.prot 4 datë 12.06.2014, Aktvendim të pushimit vjetor të vitit 2004, Deklaratë e ish

Drejtorit të NSH-së, I S, një Deklaratë tjetër e paditësit dhe Vendimin për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së.

Bazuar në këto prova, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë pjesërisht e ka aprovuar ankesën e paditësit dhe e ka ndryshuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit duke detyruar AKP-në që paditësit në emër të pagave të papaguara për 36 muaj nga qershor 2011 e deri në qershor 2014 ti paguaj shumën prej 4,248.00 euro, interesin ligjor prej 10% të shumës themelore, në shumë prej 424.80 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Me pikën e 5 të dispozitivit, shkalla e I-rë e refuzon si të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesës në shumë prej 11,902.00, si dhe shpenzimet e përfaqësimit prej 208 euro.

Paditësi me provat e ofruara në gjykatë mjaftueshëm ka vërtetuar se ai ka ofruar shërbime pune tek NSH-ja deri në ditën e likuidimit të saj, dhe në bazë të Listës së pagave të lëshuar nga NSH-ja, vërtetohet se NSH-ja e ka pranuar ekzistimin e borgjit për paga, andaj shkalla e I-rë për periudhën që nuk është parashkruar, me të drejtë ja njeh paditësit shumën prej 4,248.80 euro, si dhe interesin ligjor prej 10% të shumës themelore prej 424.80 euro të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon si të pa bazuar ankesën e AKP-së dhe e vërteton Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Prandaj nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 27 maj 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 17 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____